



Plan Veprimi për kompaninë **DruTech**.

Pas vizitës studimore të realizuar në kompaninë DRU TECH, kam hartuar planin e mëposhtëm të veprimit bazuar nëvëzhgimet e realizuara gjatë vizitës dhe në analizën e aktivitetit të kompanisë. Qëllimi i këtij plani është të analizojë funksionimin e kompanisë, sfidat kryesore me të cilat përballë dhe mundësitë për zhvillim të qëndrueshëm përmes menaxhimit të risqeve, përmirësimit të efikasitetit operacional dhe integritetit praktikave të ekonomisë qarkulluese.

Gjatë vizitës në ambientet e kompanisë u analizuan struktura organizative, proceset teknologjike dhe produktet kryesore që realizohen nga kompania. DRU TECH është një kompani që operon në sektorin e përpunimit të drurit dhe është e specializuar në përdorimin e drurit natyral, kryesisht të llojeve ah, lis dhe arrë. Produktet kryesore të kompanisë përfshijnë suprinatavolinash, mobilje të ndryshme prej druri, panele dekorativemurale dhe elemente të personalizuar dekorative. Procesi i prodhimit realizohet përmes një kombinimi të punës artizanale dhe teknologjisë moderne, duke përdorur makineri të specializuara si sharra industriale, torno, makineri për ngjitjen e suprinave dhe teknologjinë CNC për realizimin e detajeve të ndërlukuara.

Përveç analizës së aktivitetit prodhues, gjatë vizitës u identifikuan edhe disa sfida kryesore me të cilat përballë kompania në zhvillimin e saj të mëtejshëm. Ndër sfidat më të rëndësishme përmenden mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar në sektorin e marangozisë, rritja e kostove të lëndës së parë dhe nevoja për investime në teknologji dhe energji të rinovueshme. Gjithashtu, u evidentua rëndësia e integritetit praktikave të qëndrueshmërisë dhe ekonomisë qarkulluese në proceset e prodhimit, me qëllim reduktimin e ndikimit mjedisor dhe rritjen e efikasitetit operacional të kompanisë.

Bazuar në vëzhgimet dhe informacionin e mbledhur gjatë vizitës në kompani, është hartuar ky plan veprimi, i cili synon të analizojë aktivitetin e kompanisë DRU TECH dhe të propozojë qasje strategjike për zhvillimin e qëndrueshëm të saj. Plan i përfshin prezantimin e kompanisë dhe analizën e aktivitetit të saj, identifikimin e palëve të interesit dhe pritshmërive të tyre, vlerësimin e risqeve kryesore që mund të ndikojnë në aktivitetin e kompanisë, si dhe strategjitë për përmirësimin e efikasitetit operacional dhe integritetin e ekonomisë qarkulluese.

Plani i veprimit paraqet edhe hapat konkretë për implementimin e strategjive të propozuara, burimet e nevojshme dhe mënyrat e monitorimit të rezultateve përmes indikatorëve të performancës dhe raportimit periodik. Në këtë mënyrë synohet të analizohet se si një kompani në industrinë e përpunimit të drurit mund të zhvillojë një model biznesi që kombinon performancën ekonomike me përgjegjësinë mjedisore dhe sociale, duke rritur njëkohësisht konkurrueshmërinë e saj në treg.